



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Prilidh Org. / Org. Jedini / Org. Unit: 01
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 2032
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 18.10.2018
Prishtinë/A


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	17 TETOR 2018
PËR/ZA/TO:	Ministrat Udhëheqësit e Organizatave buxhetore Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore
NGA/OD/FROM:	Bedri Hamza, Ministër në Ministrinë e Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja buxhetore 2019/02. Shpallja e kufijve final buxhetorë për vitin 2019 - Qeveria Qendrore



Të nderuar Ministra,
Të nderuar udhëheqës dhe zyrtar të organizatave buxhetore,

Qëllimi

Lëshimi i Qarkores së dytë buxhetore është ofrimi i përmbylljes së propozim buxhetit për vitin 2019 nga ana e Ministrisë së Financave. Përmes Qarkores së dytë buxhetore, ju do të pranoni kufijtë final buxhetor të cilët duhet t'i ndani nëpër nën-programe e programe të organizatës suaj buxhetore. Këta kufij buxhetor mund t'i ndryshoj në të ardhmen vetëm Qeveria dhe Kuvendi duke respektuar kufijtë e jashtëm buxhetor.

Ju rikujtoj se me 15 maj 2018, Ministria e Financave ka lëshuar qarkoren buxhetore 2019/01, ku janë ofruar udhëzimet e para, kalendari indikativ si dhe kufijtë fillestar të përgatitjes së buxhetit për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021. Me këtë dokument buxhetor jeni informuar rreth kontekstit së përgatitjes së buxhetit për vitin 2019, i cili rrjedh nga KASH-i 2019-2021 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në prill të vitit 2018.

Në këtë drejtim, dorëzimet paraprake buxhetore janë plotësuar me informata shtesë që tregojnë arsyeshmërinë e plotë të kërkesave buxhetore dhe njëkohësisht janë marrë në konsideratë edhe

ndryshimet e mundshme të cilat kanë mundur të paraqiten gjatë ekzekutimit të buxhetit 2018 e të cilat ndikojnë edhe në buxhetin e vitit 2019 dhe buxhetet e viteve vijuese.

Kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve të paraqitur me Qarkoren e dytë, janë në harmoni me zotimet tona në raport me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Buxheti i vitit 2019 dhe ai i viteve pasuese 2020-2021 është vazhdimësi e KASH-it 2019-2021 dhe do të jetë në pajtim me politikat fiskale – buxhetore, për të cilat Qeveria është pajtuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që në rend të parë të ruajë stabilitetin fiskal dhe buxhetor dhe përkrah brenda kornizave kërkesat e organizatave buxhetore dhe prioritete e tyre të mbështetura nga dokumenti-Programi i Qeverisë 2018-2021.

Stabiliteti makroekonomik dhe fiskal është parakusht për funksionimin e operacioneve qeveritare dhe për krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e sektorit privat. Ministria e Financave do jetë e përkushtuar në sforcimin dhe mbarëvajtjen e stabilitetit makro-fiskal, duke u fokusuar në:

- Sigurimin e balancës së nevojshme në mes arkëtimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore;
- Zbatimin e buxheteve vjetore me strukturë kualitative, në mbështetje të implementimit të prioriteteve strategjike të Qeverisë;
- Shfrytëzimin efektiv të huamarrjes, duke siguruar qëndrueshmëri afatgjate të borxhit publik, dhe
- Mbajtjen e nivelit të mjaftueshëm të rezervave buxhetore për t'i bërë ballë rreziqeve të jashtme dhe të brendshme fiskale.

Duke ditur se rritja e qëndrueshme ekonomike dhe stabiliteti fiskal janë ngushtë të ndërlidhura dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra, Ministria e Financave, duke filluar me buxhetin e vitit 2019 dhe më pas me buxhetet e viteve vijuese, do të sigurohet në përmirësimin e pozitës aktuale fiskale të vendit dhe më pas në ruajtjen stabilitetit fiskal, gjë e cila direkt do të kontribuoj dhe mbështes një rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit. Buxhetet vjetore do të fokusohen në financimin dhe implementimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë, duke përfshirë këtu edhe financimin adekuat të programeve për mbështetje sociale dhe punësim, si një parakusht për zhvillim ekonomik të balancuar dhe gjithëpërfshirës.

Përderisa rritja e Buxhetit është e rëndësishme, po aq e rëndësishme është edhe kualiteti i tij, respektivisht përbërja strukturore e buxhetit. Në këtë kontekst, ne zotohemi për një Buxhet që financon prioritetet strategjike të Qeverisë, me investime substanciale në fushat si Arsimi, Shëndetësia, Rendi dhe Ligji, Infrastruktura, Bujqësia, Shëndetësia dhe fusha e Sigurisë. Krahas financimit të investimeve publike me norma të larta të kthimit ekonomik e social, ne zotohemi se do kujdesemi për të gjitha shtresat sociale, duke siguruar financim adekuat, dhe njëkohësisht, reformim të politikave aktuale sociale për të siguruar se këto skema përkrahin ata që janë në nevojë. Në lidhje me këtë, më lejoni të ju them se Qeveria zotohet për një rritje ekonomike të balancuar dhe gjithëpërfshirëse, nga e cila do përfitojnë të gjithë qytetarët e vendit.

E dimë që investimet e jashtme direkte janë të domosdoshme për realizimin e dinamikës sonë të projektuar për zhvillimin ekonomik. Për tërheqjen e tyre, do të sigurojmë sundim të rendit dhe ligjit, infrastrukturë ekonomike dhe siguri të plotë për investitorët.

Qeveria e Kosovës do ta ketë ofertën e vet të qartë dhe kredibile për të gjithë investitorët e mundshëm.

Dëgjimet buxhetore me të gjitha organizatat buxhetore, ku u është mundësuar të prezantoni buxhetin e juaj dhe të jepni komente rreth nivelit të burimeve të propozuara. Gjatë këtyre dëgjimeve të gjitha organizatat buxhetore u njoftuan me reflektimin e Marrëveshjes së Qeverisë me FMN-në për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020-2021. Nga organizatat buxhetore u kërkua përaftrim (pajtim) me kufijtë e lëshuar buxhetor. Gjithashtu, organizatave buxhetore u është bërë e ditur se shtimi i numrit të punëtorëve apo çdo avancim në koeficient apo pozita pune nuk mund të bëhet përtej kufirit të lëshuar me Qarkore buxhetore

Dëgjimet buxhetore megjithatë ishin të dobishme dhe komentet e juaja janë marrë parasysh brenda mundësive buxhetore në këtë qarkore.

Me buxhetin e vitit 2019, Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që në rend të parë të ruajë stabilitetin fiskal dhe buxhetor dhe të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore brenda kornizave buxhetore dhe prioritetëve të saja, si dhe zbatimin e rregullës fiskale e cila përcakton kufirin e nivelit të deficitit buxhetor në 2% të BPV-në.

Sa i përket klauzolës së investimeve dhe shumës së planifikuar për projekteve investive, një pjesë tani më janë planifikuar për projekte të caktuar.

Mjetet të ndara për shpenzime kapitale duhet të shfrytëzohen për mbulimin e obligimeve kontraktuale për projektet ekzistuese dhe mos të përfshihen projektet e reja- pa u mbuluar obligimet për projektet ekzistuese.

Kufijtë e shpenzimeve

Kufijtë e shpenzimeve për vitin 2019 përmes Qarkores së dytë buxhetore, paraqesin kufijtë final buxhetor për organizatën buxhetore në total dhe sipas kategorive ekonomike. Çdo hyrje në obligime përtej kufijve buxhetor paraqet shkelje të Ligjit të buxhetit. Nisur nga këto dokumente dhe rekomandime të dala nga dëgjimet e mbajtura, organizatat buxhetore janë të obliguara të përshtatin kërkesat e tyre buxhetore sipas situatës së re dhe të ri-shqyrtojnë politikat e tyre dhe të bëjnë prioritetizimin brenda kufijve të dhënë buxhetor të cilët shpërmdahen nëpër programe, nën-programe dhe kategori ekonomike.

Në totalin e kufirit buxhetor të dhe për organizatën buxhetore, krahas granteve dhe shpenzimeve të lejuara nga të hyrat vetanake, duhet të përfshihen gjithsesi edhe burimet e financimeve nga huamarrja.

Dua të theksoj se nuk ka hapësirë për rritje në ndonjë kategori ekonomike të një nën-programi pa zbritur shumën ekuivalente në një nën-program tjetër qoftë brenda një organizate buxhetore apo edhe ndërmjet organizatave të ndryshme buxhetore.

Organizatat buxhetore detyrimisht duhet të përfshijnë në kufijtë buxhetor të gjitha obligimet që mund t'i kenë si politika të vazhdueshme, duke përfshirë kështu edhe obligimet që rrjedhin nga Marrëveshjet ndërkombëtare dhe politikat e reja, duke përfshirë obligimet e mbetura nga viti 2018 dhe ato për vitet tjera vijuese 2019-2021.

Nga OB-të kërkohet që të dhënat në pajtim me kufijtë buxhetor t'i fusin në Sistemin për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit (SZHMB) dhe sistemin e Programit të Investimeve Publike (PIP).

Organizatat buxhetore kërkesat e tyre duhet t'i dorëzojnë më së largu më **22 Tetor 2018 deri në orën 12:00**, në Ministrinë e Financave në tri gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze. Materialet dorëzohen në kopje fizike në Arkiv dhe elektronike analistit përkatës të buxhetit në Ministrinë e Financave.

Kërkesa duhet të përfshijë:

1. Formularët e PCF-së nga sistemi i SZHMB,
2. Formularët e shtypur nga Sistemi PIP dhe
3. Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e firmosur / nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencionit me të gjitha materialet buxhetore.

Për çdo paqartësi lidhur me këtë Qarkore, ju lutem kontaktoni me analistin e juaj të buxhetit në Ministrinë e Financave.

Të bashkangjitur gjeni Shtojca 1. e cila përcakton kufijtë final të shpenzimeve për Organizatat Buxhetore.

Me respekt,

Bedri Hamza
Ministër

